VENDIM
Nr.611, datë 8.7.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.881, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE DHE PËR STRUKTURËN NIVELET E PAGAVE NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë" dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.881, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pas pikës 1/1 shtohet pika 1/2, me këtë përmbajtje:

"1/2. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1, është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e politikës së pagave të planifikuara për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

PAGA MUJORE					
POZICIONI DREJTUES	GRADA DIPLOMATIKE	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA PËR GRADË
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Sekretar i Përgjithshëm	Ambasador	1	2%		115 000
Drejtor i Përgjithshëm	Ministër fuqiplotë. Ministër këshilltar. Konsull i Përgjithshëm	1	2%		105 000
Drejtor	Këshilltar	1	2%		88 000
Përgjegjës sektori	Sekretar i Parë. Konsull.	1	2%		71 000
	Sekretar i Dytë. Zëvendëskonsull.	1 ose 2	2%		54 000
	Sekretar i Tretë. Agjent Konsullor.	1 ose 2 ose 3	2%		43 000

	Atashe	1 ose 2 ose 3	2%		33 000

Lidhja nr.3

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	**Lloji i diplomës**	**Vlera**
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND). Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND). Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP). Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	10 000 lekë